

VENDIM
Nr. 484, datë 16.7.2014

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR GJYKATËN
KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, zëri “Shpenzime kapitale”, t’i shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh.
 2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Gjykata Kushtetuese për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama